

## **UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES**

**July 11** - Panel Discussion: ChatGPT and its implications

**July 12** - Business After Hours

**July 13** - New Members Day

### **DIRECTOR'S NOTE**

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Javën që po lejmë pas angazhimi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ekipit të saj ka qenë në disa drejtime, duke shënuar edhe suksese. Po ndajmë me ju një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme dhe fotografi nga këto ngjarje:

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

The week we are leaving behind has been a busy one for the German-Kosovar Business Association and its team, as we have made progress in several areas and celebrated successes. We would like to share with you a summary of important events and photos from these occasions:

**OEGJK asistoi hapjen e tri bizneseve me investitorë gjermanë**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka asistuar hapjen e tri bizneseve të reja në Republikën e Kosovës nga dy investitorë gjermanë.

Të gjitha dokumentet, konsulltat dhe angazhimet i ka përgatitur ekipi i OEGJK-së, duke e përfunduar me sukses procesin e regjistrimit në Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), pranë Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.

Kompanitë në fjalë janë asistuar gjithashtu për hapjen e llogarive bankare pranë ProCredit Bank që është anëtare e jona Premium.

**KDWV facilitated the opening of three businesses with German investors**

The German-Kosovar Business Association has assisted in the opening of three new businesses in the Republic of Kosovo by two German investors. The KDWV team has prepared all the necessary documents, consultations, and engagements, successfully completing the registration process at the Business Registration Agency of Kosovo (ARBK), under the Ministry of Industry, Entrepreneurship, and Trade.

Furthermore, the companies in question have also been assisted in opening bank accounts with ProCredit Bank, which is a member of our Premium network.

## **U mbajt me prezencë të lartë info sesioni për pjesëmarrje në panaiet që organizohen në vendet e DACH**

Me një pjesëmarrje të gjerë të kompanive anëtare më 6 korrik 2023 u mbajt sesioni i radhës informues i organizuar bashkë me KIESA-n, Zyrën Ekonomike të Austrisë në Kosovë dhe Odën Ekonomike Zvicerane.

Mundësitë e aplikimit dhe pjesëmarrjes së kompanive vendore në panaiet që organizohen nga vendet e DACH (Gjermani, Austri dhe Zvicërr) u diskutuan gjerësisht nga pjesëmarrësit.

Kompanitë patën rastin të marrin praktikatat më të mira dhe mënyrat e përkrahjes së tyre për pjesëmarrje në panaiet në vendet e DACH. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Zef Dedaj u tregoi kompanive se si mund të kenë qasje edhe në përkrahje financiare për të marrë pjesë në panaiet jashtë vendit.

Folës në info sesion ishin: Nora Hasani, drejtoreshë e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Vigan Disha, drejtor i Odës Ekonomike Zvicerano-Kosovare, Vjosa Huruglica, drejtoreshë e Zyrës Ekonomike të Austrisë në Kosovë dhe u.d. drejtori i KIESA-s, Zef Dedaj.

## **An information session on participating in trade fairs organized in the DACH countries was held with a strong presence**

With broad participation from member companies, an informative session was held on July 6, 2023, organized jointly by KDWV, the Austrian Economic Office in Kosovo, the Swiss Economic Chamber, and KIESA. The possibilities of application and participation of local companies in trade fairs organized by the DACH countries (Germany, Austria, and Switzerland) were extensively discussed by the participants.

Companies had the opportunity to learn about best practices and support mechanisms for participating in trade fairs in the DACH countries. Zef Dedaj, the Acting Director of the Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA), informed the companies about accessing financial support for participating in international trade fairs.

The speakers at the information session were Nora Hasani, Director of the German-Kosovar Business Association, Vigan Disha, Director of the Swiss-Kosovar Economic Chamber, Vjosa Huruglica, Director of the Austrian Economic Office in Kosovo, and Zef Dedaj, Acting Director of KIESA.



## **Drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani mori pjesë në ProCredit Green Day**

ProCredit Bank, si anëtare premium e OEGJK-së dhe me drejtoreshë Eriola Bibollin që është kryetare e Bordit të OEGJK-së ka organizuar gjatë javës ProCredit Green Day.

Më shumë se 220 mysafirë nga 8 vende ishin pjesë në diskutimin mbi efikasitetin e energjisë dhe potencialin e energjisë së ripërtëritshme si dhe në ceremoninë e inaugurimit të parkut të parë fotovoltaiik në Kosovë në pronësi të një grupi bankar.

Inaugurimi i parkut fotovoltaiik prej 3MW ProEnergy është moment historik dhe i rëndësishëm për Bankën ProCredit Kosova, për grupin ProCredit dhe për vendin tonë.

Drejtoresha ekzekutive e OEGJK-së, Nora Hasani, mori pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme, që gëzon tejmase odën me suksesin e madh që ka arritur PCB, duke ecur me hapa galopant në drejtim të dekarbonizimit si një prej qëllimeve të mijëvjeçarit.



## **The Director of KDWV, Nora Hasani, participated in ProCredit Green Day**

ProCredit Bank, as a premium member of KDWV, with Chairwoman Eriola Bibolli, who is also the Chair of the KDWV Board, organized ProCredit Green Day during the week.

More than 220 guests from 8 countries participated in the discussion on energy efficiency and the potential of renewable energy, as well as in the inauguration ceremony of the first photovoltaic park in Kosovo, owned by a banking group.

The inauguration of the 3MW ProEnergy photovoltaic park is a historic and important moment for ProCredit Bank Kosovo, the ProCredit group, and our country.

Nora Hasani, the Executive Director of KDWV, participated in this significant event, which greatly pleased the chamber with the great success achieved by PCB, making significant strides towards decarbonization as one of the millennium goals.



## **OEGJK priti në takim deputetin e Parlamentit të Hamburgut, Dr. Sven Tode**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) ka pritur gjatë javës në takim z. Dr. Sven Tode, deputet i Parlamentit të Hamburgut. Ky takim u shfrytëzua për të theksuar përparimet e rëndësishme në sektorin e transportit dhe logjistikës në Kosovë.

OEGJK i bëri të ditur z. Tode se ministri i infrastrukturës i Kosovës, Liburn Aliu, në planin e tij të punës ka vënë theks të veçantë në këto fusha dhe fondet e Bashkimit Evropian janë në dispozicion për investime të rëndësishme. Po ashtu, OEGJK thekson nevojën për trajnim të të rinjve për këto projekte, pasi aktualisht ka mungesë të burimeve njerëzore në sektorin e hekurudhës.

Në fushën e arsimit profesional dhe trajnimit dual, OEGJK rekomandoi shkëmbimin me përfaqësuesit e projektit të Arsimit Profesional të GIZ, përpara se të diskutohen ide konkrete me qeverinë.

Përveç kësaj, OEGJK theksoi nevojën për zgjidhje të shpejta në sektorin e energjisë, që të trajnohet një numër punëtorësh jashtë sektorit publik. Iniciativa për krijimin e një qendre trajnimi të ndërmarrjeve për sektorin e energjisë konsiderohet si një hap i rëndësishëm për të adresuar mungesën e punonjësve të kualifikuar në fushat e energjisë diellore dhe efikasitetit të energjisë.

OEGJK i është gëzuar zhvillimeve pozitive në sektorin e transportit dhe logjistikës dhe konfirmon përkushtimin e saj për të promovuar bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm.

## **KDWW hosted a meeting with Sven Tode, a member of the Hamburg Parliament**

The German-Kosovar Business Association (KDWW) received Mr. Dr. Sven Tode, a member of the Hamburg Parliament, for a meeting during the week. This meeting was used to emphasize the significant progress in the transport and logistics sector in Kosovo.

KDWW informed Mr. Tode that Kosovo's Minister of Infrastructure, Liburn Aliu, has placed special emphasis on these areas in his work plan, and European Union funds are available for important investments. Additionally, KDWW highlighted the need for training young people for these projects, as there is currently a shortage of human resources in the railway sector.

In the field of vocational education and dual training, KDWW recommended engaging with representatives from the GIZ Vocational Education Project before discussing concrete ideas with the government.

Furthermore, KDWW stressed the need for swift solutions in the energy sector to train a number of workers outside the public sector. The initiative to establish enterprise training centers for solar energy and energy efficiency is considered an important step in addressing the shortage of qualified personnel.

KDWW expressed its satisfaction with the positive developments in the transport and logistics sector and reaffirmed its commitment to promoting collaboration among different stakeholders.

## **OEGJK priti në takim kryetarin e Bordit të ProCredit Holding AG, z. Spechtenhauser**

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ka pasur një mysafir të rëndësishëm gjatë javës, sikur ka qenë z. Hubert Spechtenhauser, kryetar i Bordit të ProCredit Holding AG.

Në këtë takim u vlerësua bashkëpunimi i suksesshëm deri më tani dhe u diskutuan hapat e mëtejshëm për thellimin dhe zgjerimin e partneritetit.

OEGJK dhe Pro Credit Holding AG kanë tashmë një bashkëpunim të frytshëm dhe ky takim ofroi një mundësi të çmuar për të çuar bashkëpunimin në një nivel të ri. Veçanërisht u vlerësua zgjedhja e zonjës Eriola Bibolli, Drejtoreshës e ProCredit Bank Kosovo, si kryetare e Bordit të OEGJK në qershor 2023. Ky zhvillim ka forcuar edhe më shumë lidhjen mes dy organizatave.

Në bisedë u shpreh qëllimi për të zgjeruar dhe thelluar bashkëpunimin ekzistues. Një fokus do të jetë organizimi i ngjarjeve të përbashkëta B2B, në Kosovë dhe në Gjermani. OEGJK dhe Pro Credit Holding AG janë të bindur se ngjarjet B2B të tilla do të ndihmojnë në promovimin e tregtisë dhe investimeve ndërmjet dy vendeve dhe do të eksplorojnë potencialin e plotë të të dy tregjeve.

## **KDWV hosted a meeting with the Chairman of the Board of ProCredit Holding AG, Mr. Spechtenhauser.**

The German-Kosovar Business Association (KDWV) had an important guest during the week, Mr. Hubert Spechtenhauser, Chairman of the Board of ProCredit Holding AG.

During the meeting, the successful collaboration thus far was appreciated, and further steps were discussed to deepen and expand the partnership.

KDWV and ProCredit Holding AG already have a fruitful collaboration, and this meeting provided a valuable opportunity to take the cooperation to a new level. In particular, the selection of Ms. Eriola Bibolli, Director of ProCredit Bank Kosovo, as the Chairwoman of the KDWV Board in June 2023 was highly appreciated. This development further strengthened the connection between the two organizations.

The aim was expressed to broaden and deepen the existing collaboration. One focus will be on organizing joint B2B events in Kosovo and Germany. KDWV and ProCredit Holding AG are confident that such B2B events will help promote trade and investment between the two countries and explore the full potential of both markets.

## **U shënua 9-vjetori i European Investors Council - Këshilli i Investitorëve Evropian**

Gjatë kësaj jave u shënua 9-vjetori i themelimit të Këshillit të Investitorëve Evropian në Kosovë, si një organ mjaft i rëndësishëm në avokimin dhe angazhimin biznesor në vend.

Këshilli përgjatë këtyre viteve ka luajtur një rol kyq në shumë procese, ku shpesh herë ka qenë krah për krah me Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare.

OEGJK i uron EIC-së këtë përvojtor, duke u dëshiruar rrugëtim të suksesshëm në vitet e ardhshme.



**Faleminderit!**

## **The 9th anniversary of the European Investors Council was celebrated**

During this week, the 9th anniversary of the establishment of the European Investors Council in Kosovo was celebrated, marking an important milestone for the advocacy and business engagement in the country.

Throughout these years, the Council has played a crucial role in various processes, often standing side by side with the German-Kosovar Business Association.

KDWV congratulates EIC on this anniversary, wishing them a successful journey in the years to come.



**Thank you!**

**↓ MORE INFORMATION BELOW ↓**

## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Znj. Sytrime Dervisholli,  
Udhëheqëse e departamentit  
për marrëdhënie me qeverinë  
dhe avokim mund ta  
kontaktoni në:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Sytrime Dervisholli, Head of  
Department for Government  
Relations and Advocacy can  
be contacted at:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Ekipi i znj. Dervisholli nuk është vetëm përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve, por gjithashtu koordinon gjashtë grupet punuese të OEGJK-së, dhe punon në publikimet tona, si dhe në raportet sektoriale:

[Publikimet e OEGJK-së](#)

The team of Ms. Dervisholli is not only responsible for representing the interests of KDWV-members, but also coordinates the six working groups of KDWV, and works on our publications, as well as on sector reports:

[Publications](#)



Udhëheqëse e  
departamentit për  
mbështetjen dhe  
shërbimet e anëtarëve  
është znj. znj. Besarta  
Hyseni:

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Head of Market Entry and  
Events is:

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Ekipi i znj. Hyseni jo vetëm që mbështet anëtarët me eksport, këshilla ligjore (kemi këshilltarë ligjorë në ekip), këshilla për Joint Venture, Franchise dhe Senior Expert Service, por gjithashtu organizon takime B2B, udhëtime delegacioni, punëtori dhe ngjarje informuese për anëtarët.

The team of Ms. Hyseni not only supports members regarding export, legal advisory services (KDWV has in-house lawyers), Joint Venture, Franchise and Senior Expert Service, but also organizes B2B meetings, delegation trips, workshops, and info-sessions for members.



Për çështje financiare (pagesa  
e anëtarësimit/faturat etj.)  
mund ta kontaktoni znj. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)

For financial matters  
(membership fees/invoices,  
etc.) please contact Ms. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



Për këshillim ligjor të  
investitorëve gjerman dhe  
anëtarëve të OEGJK mund  
ta kontaktoni znj. Gonxhe  
Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

For legal advice to German  
Investors and members of  
KDWV please contact Ms.  
Gonxhe Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

### BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina  
Monday - Friday | 8.30 - 16.30